A K T N O R M A T I V
Nr.5, datë 31.8.2001

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8668, DATË 23.10.2000 "PËR PAJISJEN E SHTETASVE SHQIPTARË ME PASAPORTË PËR JASHTË SHTETIT"

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8668, datë 23.10.2000 "Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit" bëhen ndryshimet si më poshtë vijojnë:

Neni 1

Pas nenit 14 shtohet neni 14/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 14/1

Neni 3 i këtij ligji do të zbatohet pas datës 30.6.2002. Deri në këtë datë do të zbatohen paragrafet 2 e 4 të nenit 2 dhe neni 14 i dekretit nr.7393, datë 12.6.1990 "Për lëshimin e pasaportave për jashtë shtetit dhe dhënien e vizave"."

Neni 2

Në fund të nenit 15 shtohen fjalët si më poshtë vijojnë:

"…duke mbetur në fuqi përkohësisht dispozitat e përcaktuara në nenin 14/1 të këtij ligji."

Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta